



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 29 prot.

Kamëz, më 27.3.2026

V E N D I M

Nr. 26 .Datë 27.3 2026

M B I

**“MBËSHTETJEN FINANCIARE TË SHOQATËS SPORTIVE “FUTBOLL TRIUMPH AKADEMY” PËR REALIZIMIN E TURNEUT NDËRKOMBËTAR TË FUTBOLLIT, “AF TRIUMPH CUP EVENTS 2026”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 27.3.2026, pasi mori në shqyrtim Projektvendimin Nr.22 Datë 19.03.2026 në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 33, nenit 54, shkronja “k” dhe nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”, të ndryshuar, V.K.B. Kamëz Nr. 90, datë 17.12.2025 “Për miratimin e detajuar të buxhetit për vitin 2026 dhe planit të buxhetit për vitet 2026 , 2027, dhe 2028., si dhe në bazë të kërkesës së Shoqatës Sportive “Futboll Triumph Academy”, Drejtoria e Arsimit Rinisë dhe sportit, Bashkia Kamëz; **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e mbështetjes financiare në masën 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për Shoqatën Sportive “Futboll Triumph Academy”, për organizimin e turneut ndërkombëtar të futbollit të moshave “AF Triumph Cup Events 2026”, që do të zhvillohet në datat 5, 6 dhe 7 Prill 2026 në Bashkinë Kamëz.
2. Fondi do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Kamëz për vitin 2026, programi i sportit, sipas strukturës buxhetore Gr. 0, Kap. 5, Prog. 08130, Art. 602
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI  
Hysen KOLDASHI

